



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 4188

Prishtinë, Dt. 10/10/2024

**RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER**

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Matematikë / Master në Shkencë Kompjuterike
Projekt propozimi	Analizimi dhe parashikimi i ndikimit të faktorëve të ndryshëm në performancën akademike të studentëve
Kandidati	Ilir Kiqmari
Mentori	Prof. Assoc. Dr. Ermir Rogova
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 28.03.2024
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 1106

Vlerësimi i dorëshkrimit

Hyrje

Punimi i diplomës me titull "Analizimi dhe parashikimi i ndikimit të faktorëve të ndryshëm në performancën akademike të studentëve" ka për qëllim të analizojë ndikimin e faktorëve të ndryshëm në performancën akademike të studentëve në Kosovë dhe në Shqipëri. Kjo mundohet të arrihet duke identifikuar këta faktorë përmes pyetësorëve me studentë, rishikimit të literaturës dhe në fund përmes analizës të të dhënave të ofrojë rekomandime.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i dorëshkrimit është bërë në saje të punës origjinale, cilësisë hulumtuese, metodologjisë, analizës dhe prezantimit në dorëshkrim.

Përmbajtja e detajuar

Në kapitullin e parë, kandidati përshkruan faktorët që ndikojnë në performancën akademike, duke vazhduar me pyetjet kërkimore të hulumtimit, dhe kontributin kryesor që pritet nga ky hulumtim.

Kapitulli i dytë fillon me një shqyrtim të literaturës në katër baza elektronike, ku në fund u përzgjedhën 73 punime të cilat përshkruhen në dy aspekte: nga aspekti i faktorëve të identifikuar dhe nga qasja e të mësuarit të makinës.

Kapitulli i tretë shpjegon metodologjinë e përdorur, në rastet e përmbledhjes së literaturës, mbledhjes të të dhënave, përgatitjes, algoritmet të analizës, modelimit të tyre, e deri te rekomandimet që kanë rrjedhur.

Kapitulli i katërt, merret me analizën e të dhënave, paraprakisht duke përshkruar të dhënat e mbledhura. Analiza bëhet nga dy kontekstet: atij të Kosovës dhe atij të Shqipërisë.

Kapitulli i pestë shpjegon procedurën e eksperimentit, dhe rezultatet e rrjedhura nga eksperimenti. Në fund të kapitullit diskutohet mbi të gjeturat dhe jepen rekomandime për institucionet.

Përmbledhje e të gjeturave




Punimi i diplomës Master ka një analizë të mirë, shqyrtim të literaturës dhe analizë të të dhënave të mbledhura. Kandidatit i është kërkuar nga anëtarët e komisionit të përmirësojë çështje të caktuara në secilin kapitull, të cilat kandidati i ka inkorporuar në punim diplomës.

Konkludim

Në përgjithësi tema e diplomës Master i përmbush standardet për të fituar gradën shkencore Master. Komisioni rekomandon pranimin e temës, pas ndryshimeve të vogla, të cilat kandidati i ka rregulluar, duke i përcjellë komentet e anëtarëve.

Prishtinë, 10/10/2024

Komisioni:

1. 
Prof. Ass. Dr. Eliot Bytyçi – kryetar
2. 
Prof. Assoc. Dr. Ermir Rogova – anëtar
3. 
Prof. Ass. Dr. Artan Berisha – anëtar